



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 289/2020**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.07.2020 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

- Objekt:** “Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Medi - Tel” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-56670-04-23-2020, me objekt “*Sherbim Eliminim mbetjesh te rrezikshme - Marrëveshje Kuadër me nje operatorë ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar(12 muaj)*”, me fond limit 7.279.200 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 18.05.2020, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”.
- Ankimues:** “V.A.L.E Recycling” sh.p.k.  
Fushë Kuqe, Gurëz, afër ish Kanalit të Acidit, Lezhë
- Autoriteti Kontraktor:** Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”  
Bulevardi “Bajram Curri”, Tiranë
- Subjekte të interesuar:** “Medi – Tel” sh.p.k.  
Autostrada Tiranë-Durrës, km.1, rr.”Vidhëgjatë”, ndërtesa nr.18,  
ZK.2679, Kashar, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit*”

*publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 24.04.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-56670-04-23-2020, me objekt “*Sherbim Eleminim mbetjesh te rrezikshme - Marrëveshje Kuadër me nje operatorë ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar(12 muaj)*”, me fond limit 7.279.200 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 18.05.2020, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “*Koço Gliozheni*”.

II.2. Në datën 18.05.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 18.05.2020 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- |                                 |                               |
|---------------------------------|-------------------------------|
| 1. “Medi - Tel” sh.p.k.         | 4.392.000 lekë, kualifikuar   |
| 2. “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k. | 4.680.000 lekë, kualifikuar   |
| 3. “Eco Riciklim” sh.p.k.       | 11.520.000 lekë, skualifikuar |

II.4. Në datën 26.05.2020 operatori ekonomik “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke pretenduar si më poshtë vijon:

[...]

*Autoriteti Kontraktor SUOGJ Koco Glozheni (AK), ka njoftuar ne SPE me date 23.04.2020 hapjen e procedurave per realizimin e sherbimit "Evadimi i mbetjeve te rrezikshme spitalore" me fond limit 7.279.200 (shtate milion e dyqind e shtatedhete e nente mije e dyqind) leke pa TVSH. Pasi morem pjese me date 18.05.2020, ne proceduren objekt i kesaj ankese, ne po te njejten date, u njoftuam ne SPE per rezultatet e vleresimit te ofertave nga KVO si vijon:*

<i>Operatoret Ekonomike</i>	<i>Vlera e ofertuar</i>	<i>Refuzuar</i>
<i>MEDI -TEL</i>	<i>4.392.000</i>	<i>Jo</i>
<i>V.A.L.E. RECYCLING</i>	<i>4.680.000</i>	<i>Jo</i>
<i>ECO RICIKLIM</i>	<i>11.520.000</i>	<i>Po</i>

*Ne i kundershtojme procedurat dhe rezultatet e ketij vleresimi per shkaqet dhe me argumentat ne vijim:*

*1. KVO e AK nuk ka zbatuar kerkesat e nenit 56 te LPP dhe nenit 66 pika 5 te VKM nr.914, date 29.12.2014 ne lidhje me ofertat anomalisht te uleta:*

*KVO e AK ne te njejten dite kur u dorezuan ofertat ne SPE, menjehere nxorri edhe rezultatin e vleresimit, ku i vleresoi te pranuar/kualifikuara 2 (nje nga te cilat eshte edhe oferta jone) nga 3 ofertat e dorezuara.*

*Nga rezultati i vleresimit, ne konstatojme se si vlera e ofertes sone edhe vlera e ofertes se OE MEDI-TEL jane anomalisht te uleta. Konkretisht, oferta jone eshte rreth 35 % me e ulet se fondi limit, ndersa oferta e OE rreth 39 % me e ulet. Pavaresisht nga ky fakt, KVO nuk ka realizuar proceduren e pershkruar nga LPP dhe RrPP per sqarimin dhe argumentimin nga OE te ofertave anomalisht te uleta.*

*Konkretisht neni 56 i LPP percakton se: [...].*

*Ndersa neni 66, i VKM nr.914, date 29.12.2014, ne piken 5 te tij percakton se: [...].*

*Nga KVO e AK ne NUK na eshte kerkuar te sqarojme dhe argumentojme vleren e ofertes sone para se te vijohej me vleresimin e ofertave dhe te merrej vendim per kualifikirnin ose jo te ofertave. Duke mbajtur ne konsiderate faktin qe rezultati i vleresimit nga KVO e AK doli brenda dites, eshte e qarte se kjo procedure e sqarimit te ofertes anomalisht te ulet nuk eshte bere as per OE Medi-TEL.*

*Ne konkluzion: Ne kushtet kur KVO e ka kapercyer momentin procedural kur mund te kerkonte sqarimin dhe argumentimin e ofertave anomalisht te uleta dhe kio nuk mund te behet me pasi eshte marre dhe eshte publikuar vendimi per kualifikimin e ofertave, kerkojme qe ne riberjen e procedures te kihen ne konsiderate keto dispozita ligjore dhe nenligjore.*

*2. OE MEDI-TEL nuk disponon incinerator MediBurn 30 te prodhuesit Elastec sic e ka te deklaruar ne Lejen Mjedisore nr.3133 date 09.03.2020. KVO e AK nuk ka here verifikimin ne vend dhe kontrollin e impianteve te, sic ka njoftuar vete ne DST dhe e ka anshkaluar kete mungese serioze.*

Ne shtojcen e publikuar me date 30.04.2020, AK ka percaktuar se: "Autoriteti kontraktor rezervon te drejten pas hapjes se ofertave dhe para se te vendose per kualifikim ose jo, te kontrolloje qe impiantet e zoteruara nga OE sipas Lejeve mjedisore perkatese jane ne gjendje normale pune, duke verifikuar ne vend realizimin e nje cikli autoklavimi dhe te nje cikli incenerimi".

Ngo konsultirni me QKB, rezulton se OE MEDI-TEL disponon 2 (dy) Leje Mjedisore te tipit A (me kod III. 1.C) per metoden e incenerimit.

(i) Lejen Mjedisore PN-3194-06-2016 me Nr. 2193 date 27.06.2016. Kjo Leje eshte leshuar per pajisjen TUDAYSURE (TS), por ne kete Leje Mjedisore OE MEDI-TEL nuk i lejohet te trajtoje me metoden e incenerimit mbetjet me kod 18 01 02 dhe 18 01 09 sic eshte kerkuar ne kriteret per kualifikim.

(ii) Lejen Mjedisore PN-9903-03-2020 me Nr. 3133 date 09.03.2020. Kjo Leje eshte leshuar per pajisjen MediBurn 30 të prodhuesit Elastec, pra I lejon OE MEDI-TEL te trajtoje me metoden e incenerimit mbetjet me kod 18 01 02 dhe 18 01 09 sic eshte kerkuar ne kriteret per kualifikim, por me pajisjen e treguar ne Leje, pra pajisjen MediBum 30.

Ne na rezulton nga kliente te ndryshem tanet se OE MEDI-TEL nuk disponon ne fakt inceneratorin MediBum 30, por vetem ate TUDA YSURE modelin TS 150 i modifikuar ne kontenier, i cili sipas Lejes Mjedisore Nr. 2193 date 27.06.2016 nuk eshte i lejuar te trajtoje mbetjet me kodet 18 01 02 dhe 18 01 09 me metoden e incenerimit.

Nese KVO e AK do kishte bere verifikimin ne terren sic ka percaktuar vete ne DST, do kishte konstatuar kete mangesi dhe nuk duhej ta kishte kualifikuar OE MEDI - TEL.

Ne konkluzion: Kerkojme qe OE MEDI-TEL te skualifikohet, pasi nuk mund te realizoje incenerimin e mbetjeve me kod 18 01 02 dhe 18 01 09 me pajisjen sipas Lejes Mjedisore Nr.3133 date 09.03.2020.

3. OE MEDI-TEL nuk ploteson piken 2.3.4 te Kapacitetit Teknik ne lidhje me ISO-t

AK ka percaktuar ne piken 2.3.4. te Kapacitetit Teknik se:

“Operatori Ekonomik ofertues duhet te jete i paisur dhe te paraqese certifikatat perkatese te vlefshme sipas objektit qe prokurohet, si me poshte:

Pajisur me certifikate:

- Certifikate SSH/EN ISO 9001:2015 Sistemi i Menaxhimit te Cilesise,
- Certifikate SSH/EN ISO 14001:2015 Per sistemin e Menaxhimit te Mjedisit,
- Certifikate BS OHSAS 18001:2007 ose ISO 45001:2018 Per Sistemin e Menaxhimit te Sigurise ne Pune. Ne Zbatim te te rekomandimit te APP dhe DPA date 20.03.2018, te gjitha certifikatat e cilesise duhet te jene te vlefshme dhe te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilesise jane te akredituar nga DPA, ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise”.

Nga eksperiencia jone dhe konsultimet me eksperte te certifikimit ISO, qe nje certifikate ISO te konsiderohet e vlefshme, kur ka kaluar nje vit apo me shume nga momenti i leshimit te saj, ajo duhet gjithmone te shoqerohet me konfirmimin e vlefshmerise vjetore, pra ti jete nenshtruar auditimit vijues vjetor qe konfirmon vlefshmerine e Certifikimit ISO perkates.

Ne dijenine tone, OE MEDI - TEL edhe ne kliente private te ndryshem, nuk i shoqeron Certifikatat ISO te veta me konfirmimin vjetor te vlefshmerise pra me konfirmimin e auditimit vijues vjetor. Ne rrethanat e mesiperme, Certifikatat ISO te OE MEDI-TEL nuk mund te konsiderohen te vlefshme, ndaj kjo perben shkak per skualifikim, pasi vete AK ka percaktuar qe Certifikatat ISO duhet te jene "te vlefshme".

*Në konkluzion: Kerkojme qe OE Medi Tel te skualifikohet, pasi nuk permbush piken 2.3.4 te Kapacitetit Teknik ne lidhje me ISO-t.*

II.5. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues ky i fundit pretendon se në datë 28.07.2020 ka marrë dijëni me anë të postës elektronike, në lidhje me shkresën e autoritetit kontraktor nr.584 prot, datë 27.05.2020 me objekt “Procesverbal”, me përmbajtje si më poshtë:

*[...]*

*Ankesa juaj u shqyrtua me kujdes dhe u vendos: Te merret parasysht per piken 1 te ankeses tuaj ne lidhje me ofertat anomalisht e ulta nga subjektet:*

- 1. Medi – Tel me oferte ekonomike 4.392.000 leke pa Tvsh*
- 2. V.A.L.E Recycling me oferte ekonomike 4.680.000 pa Tvsh*

*Për sa më sipër ju bëjmë me dije se bazuar ne VKM nr.914, datë 29.12.2014 neni 56 te LPP kerkojme nga ana juaj argumentimin e ofertes se paraqitur pasi jeni kualifikuar si oferte e suksesshme dhe oferta juaj rezulton anomalisht e ulet pas perlllogaritjes nga komisioni.*

II.6. Në datën 08.06.2020 operatori ekonomik “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke pretenduar si më poshtë:

*[...]*

*Autoriteti Kontraktor SUOGJ Koco Glozheni (AK), ka njoftuar ne SPE me date 23.04.2020 hapjen e procedurave per realizimin e sherbimit "Evadimi i mbetjeve te rrezikshme spitalore" me fond limit 7.279.200 (shtate milion e dyqind e shtatedhete e nente mije e dyqind) leke pa TVSH. Pasi morem pjese me date 18.05.2020, ne proceduren objekt i kesaj ankese, ne po te njejten date, u njoftuam ne SPE per rezultatet e vleresimit te ofertave nga KVO si vijon:*

<i>Operatoret Ekonomike</i>	<i>Vlera e ofertuar</i>	<i>Refuzuar</i>
<i>MEDI -TEL</i>	<i>4.392.000</i>	<i>Jo</i>
<i>V.A.L.E. RECYCLING</i>	<i>4.680.000</i>	<i>Jo</i>
<i>ECO RICIKLIM</i>	<i>11.520.000</i>	<i>Po</i>

*Ne i kundershtojme procedurat dhe rezultatet e ketij vleresimi per shkaqet dhe me argumentat ne vijim:*

*1. KVO e AK nuk ka zbatuar kerkesat e nenit 56 te LPP dhe nenit 66 pika 5 te VKM nr.914, date 29.12.2014 ne lidhje me ofertat anomalisht te uleta:*

*KVO e AK ne te njejten dite kur u dorezuan ofertat ne SPE, menjehere nxorri edhe rezultatin e vleresimit, ku i vleresoi te pranuar/kualifikuara 2 (nje nga te cilat eshte edhe oferta jone) nga 3 ofertat e dorezuara.*

*Nga rezultati i vleresimit, ne konstatojme se si vlera e ofertes sone edhe vlera e ofertes se OE MEDI-TEL jane anomalisht te uleta. Konkretisht, oferta jone eshte rreth 35 % me e ulet se fondi limit, ndersa oferta e OE rreth 39 % me e ulet. Pavaresisht nga ky fakt, KVO nuk ka realizuar proceduren e pershkruar nga LPP dhe RrPP per sqarimin dhe argumentimin nga OE te ofertave anomalisht te uleta.*

*Konkretisht neni 56 i LPP percakton se: [...].*

*Ndersa neni 66, i VKM nr.914, date 29.12.2014, ne piken 5 te tij percakton se: [...].*

*Nga KVO e AK ne NUK na eshte kerkuar te sqarojme dhe argumentojme vleren e ofertes sone para se te vijojej me vleresimin e ofertave dhe te merrej vendim per kualifikirnin ose jo te ofertave.*

*Duke mbajtur ne konsiderate faktin qe rezultati i vleresimit nga KVO e AK doli brenda dites, eshte e qarte se kjo procedure e sqarimit te ofertes anomalisht te ulet nuk eshte bere as per OE Medi-TEL.*

*Ne konkluzion: Ne kushtet kur KVO e ka kapercyer momentin procedural kur mund te kerkonte sqarimin dhe argumentimin e ofertave anomalisht te uleta dhe kjo nuk mund te behet me pasi eshte marre dhe eshte publikuar vendimi per kualifikimin e ofertave, kerkojme qe ne riberjen e procedures te kihen ne konsiderate keto dispozita ligjore dhe nenligjore.*

*2. OE MEDI-TEL nuk disponon incinerator MediBurn 30 te prodhuesit Elastec sic e ka te deklaruar ne Lejen Mjedisore nr.3133 date 09.03.2020. KVO e AK nuk ka here verifikimin ne vend dhe kontrollin e impianteve te, sic ka njoftuar vete ne DST dhe e ka anshkaluar kete mungese serioze.*

*Ne shtojcen e publikuar me date 30.04.2020, AK ka percaktuar se: "Autoriteti kontraktor rezervon te drejten pas hapjes se ofertave dhe para se te vendose per kualifikim ose jo, te kontrolloje qe impiantet e zoteruara nga OE sipas Lejeve mjedisore perkatese jane ne gjendje normale pune, duke verifikuar ne vend realizimin e nje cikli autoklavimi dhe te nje cikli incenerimi".*

*Ngo konsultirni me QKB, rezulton se OE MEDI-TEL disponon 2 (dy) Leje Mjedisore te tipit A (me kod III. l. C) per metoden e incenerimit.*

*(i) Lejen Mjedisore PN-3194-06-2016 me Nr. 2193 date 27.06.2016. Kjo Leje eshte leshuar per pajisjen TUDAYSURE (TS), por ne kete Leje Mjedisore OE MEDI-TEL nuk i lejohet te trajtoje me metoden e incenerimit mbetjet me kod 18 01 02 dhe 18 01 09 sic eshte kerkuar ne kriteret per kualifikim.*

*(ii) Lejen Mjedisore PN-9903-03-2020 me Nr. 3133 date 09.03.2020. Kjo Leje eshte leshuar per pajisjen MediBurn 30 te prodhuesit Elastec, pra I lejon OE MEDI-TEL te trajtoje me metoden e incenerimit mbetjet me kod 18 01 02 dhe 18 01 09 sic eshte kerkuar ne kriteret per kualifikim, por me pajisjen e treguar ne Leje, pra pajisjen MediBum 30.*

*Ne na rezulton nga kliente te ndryshem tanet se OE MEDI-TEL nuk disponon ne fakt inceneratorin MediBum 30, por vetem ate TUDA YSURE modelin TS 150 i modifikuar ne kontenier, i cili sipas Lejes Mjedisore Nr. 2193 date 27.06.2016 nuk eshte i lejuar te trajtoje mbetjet me kodet 18 01 02 dhe 18 01 09 me metoden e incenerimit.*

*Nese KVO e AK do kishte bere verifikimin ne terren sic ka percaktuar vete ne DST, do kishte konstatuar kete mangesi dhe nuk duhej ta kishte kualifikuar OE MEDI - TEL.*

*Ne konkluzion: Kerkojme qe OE MEDI-TEL te skualifikohet, pasi nuk mund te realizoje incenerimin e mbetjeve me kod 18 01 02 dhe 18 01 09 me pajisjen sipas Lejes Mjedisore Nr.3133 date 09.03.2020.*

*3. OE MEDI-TEL nuk ploteson piken 2.3.4 te Kapacitetit Teknik ne lidhje me ISO-t  
AK ka percaktuar ne piken 2.3.4. te Kapacitetit Teknik se:*

*"Operatori Ekonomik ofertues duhet te jete i paisur dhe te paraqese certifikatat perkatese te vlefshme sipas objektit qe prokurohet, si me poshte:*

*Pajisur me certifikate:*

- Certifikate SSH/EN ISO 9001:2015 Sistemi i Menaxhimit te Cilesise,*
- Certifikate SSH/EN ISO 14001:2015 Per sistemin e Menaxhimit te Mjedisit,*
- Certifikate BS OHSAS 18001:2007 ose ISO 45001:2018 Per Sistemin e Menaxhimit te Sigurise ne Pune. Ne Zbatim te te rekomandimit te APP dhe DPA date 20.03.2018, te gjitha certifikatat e cilesise duhet te jene te vlefshme dhe te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit te*

*cilesise jane te akredituar nga DPA, ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise”.*

*Nga eksperiencia jone dhe konsultimet me eksperte te certifikimit ISO, qe nje certifikate ISO te konsiderohet e vlefshme, kur ka kaluar nje vit apo me shume nga momenti i leshimit te saj, ajo duhet gjithmone te shoqerohet me konfirmimin e vlefshmerise vjetore, pra ti jete nenshtuar auditimit vijues vjetor qe konfirmon vlefshmerine e Certifikimit ISO perkates.*

*Ne dijenine tone, OE MEDI - TEL edhe ne kliente private te ndryshem, nuk i shoqeron Certifikatat ISO te veta me konfirmimin vjetor te vlefshmerise pra me konfirmimin e auditimit vijues vjetor. Ne rrethanat e mesiperme, Certifikatat ISO te OE MEDI-TEL nuk mund te konsiderohen te vlefshme, ndaj kjo perben shkak per skualifikim, pasi vete AK ka percaktuar qe Certifikatat ISO duhet te jene "te vlefshme".*

*Në konkluzion: Kerkojme qe OE Medi Tel te skualifikohet, pasi nuk permbush piken 2.3.4 te Kapacitetit Teknik ne lidhje me ISO-t.*

*Ne kemi paraqitur ankesen tone ne AK me date 26.05.2020.*

*Autoriteti Kontraktor SUOGJ Koco Glozheni (AK), pas paraqitjes se ankeses sone me date 26.05.2020, nuk na ka kthyer asnje pergjigje te plote per rezultatet e shqyrtimit te ankeses, por vetem na ka derguar me email ne date 28.05.2020, shkresen nr.584 date 27.05.2020, me ane te se ciles pretendon se eshte pranuar pika e ankeses sane ne lidhje me mosverifikimin e ofertave anomalisht te uleta dhe na kerkon te japim sqarimet tona ne lidhje me ofertat anomalisht te ulet. Kjo kerkese e AK eshte teresisht ne kundershtrim me percaktimet dhe procedurat e nenit 56 te LPP dhe nenit 66 pika 5 te VKM nr.914, date 29.12.2014 ne lidhje me ofertat anomalisht te uleta, pasi ashtu edhe sic eshte kerkuar ne ankesen tone, sqarimet per ofertat anomalisht te uleta kerkohen para se te perfundohet vleresimi i ofertave.*

*Ne fakt AK e ka perfunduar vleresimin e ofertave me date 18.05.2020, pra kerkesa ne kete moment nuk ka asnje kuptim dhe nuk eshte ne perputhje me ligjin, por duket haptazi se eshte thjesht nje perpjekje e AK per te justifikuar dhe mbuluar paligjshmerite e veta.*

*Sidoqofte, V.A.L.E Recycling iu pergjigj kerkeses se AK per sqarimin e ofertes anomalisht te ulet, por keto sqarime nuk duhen lexuar si pranim i qendrimit te mbajtur nga AK, por nje demonstrim i mundesisese VALE Recycling per te argumentuar cdo element te ofertes, si dhe per te evituar qe AK ta perdore mosofrimin e argumentimeve si pretekst per skualifikim.*

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 662 prot., datë 15.06.2020, protokolluar me tonën në datën 18.06.2020, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

## Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, në zbatim të nenit 30, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përbashimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.1.1. Marrë shkas nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k. i cili kundërshton veprimet e autoritetit kontraktor, konkretisht, “KVO e AK nuk ka zbatuar kërkesat e nenit 56 të LPP dhe nenit 66 pika 5 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 në lidhje me ofertat anomalisht të uleta: KVO e AK në të njëjtën ditë kur u dorëzuan ofertat në SPE, menjëherë nxorri edhe rezultatin e vleresimit, ku i vlerësoi të pranuar/kualifikuara 2 (një nga të cilat është edhe oferta jone) nga 3 ofertat e dorëzuara. Nga rezultati i vleresimit, në konstatohet se si vlera e ofertës sone edhe vlera e ofertës së OE MEDI-TEL janë anomalisht të uleta. Konkretisht, oferta jone është rreth 35 % me e ulet se fondi limit, ndërsa oferta e OE rreth 39 % me e ulet. Pavaresisht nga ky fakt, KVO nuk ka realizuar procedurën e pershkruar nga LPP dhe RrPP për sqarimin dhe argumentimin nga OE të ofertave anomalisht të uleta. Nga KVO e AK në NUK na është kërkuar të sqarohet dhe argumentohet vlerën e ofertës sone para se të vijohet me vlerësimin e ofertave dhe të merret vendim për kualifikimin ose jo të ofertave. Duke mbajtur në konsideratë faktin që rezultati i vleresimit nga KVO e AK doli brenda ditës, është e qartë se kjo procedurë e sqarimit të ofertës anomalisht të ulet nuk është bërë as për OE Medi-TEL. Në konkluzion: Në kushtet kur KVO e ka kapërcyer momentin procedural kur mund të kërkonte sqarimin dhe argumentimin e ofertave anomalisht të uleta dhe kjo nuk mund të bëhet me pasi është marrë dhe është publikuar vendimi për kualifikimin e ofertave, kërkojmë që në ribërjen e procedurës të kihet në konsideratë keto dispozita ligjore dhe nenligjore., Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se,

III.1.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 18.05.2020 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- |                                 |                               |
|---------------------------------|-------------------------------|
| 1. “Medi - Tel” sh.p.k.         | 4.392.000 lekë, kualifikuar   |
| 2. “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k. | 4.680.000 lekë, kualifikuar   |
| 3. “Eco Riciklim” sh.p.k.       | 11.520.000 lekë, skualifikuar |

III.1.3. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor të depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konkretisht shkresës nr. 661 prot., datë 15.06.2020, me objekt



“Përgjigje në zbatim të Vendimit Nr.532/1 prot datë 10.06.2020 (Prot nga ana jonë me Nr.652 dt 12.06.2020)”, autoriteti kontraktor citon: “KVO i drejtohet me shkresën nr.540 prot., datë 20.05.2020 operatorit ekonomik “Medi – Tel” sh.p.k. mbi ofertën e tij anomalisht të ulët. Me shkresën Nr.540/1 datë 20.05.2020 operatori ekonomik ka argumentuar ofertën e tij anomalisht të ulët. [...] Argumentimi i fondit për subjektin “Medi – Tel” sh.p.k. ,e ofertë me vlerë 4.392.000 lekë pa tvsh është kërkuar menjëherë pas renditjes në sistem të operatorëve ekonomikë dhe përpara shpalljes së fituesit dhe V.A.L.E Recycling sh.p.k. me vlerë 4.680.000 lekë pa tvsh menjëherë pas njohjes me ankesën pa u shpallur fituesi nga ana jonë dhe për këtë nuk kemi pse vëme në dijeni subjektin ankimues. I është kthyer përgjigje subjektit V.A.L.E Recycling sh.p.k. me datë 28.05.2020 në të cilën i kërkohet argumentimi I fondit si ofertë e suksesshme”.

III.1.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar nga autoriteti kontraktor pranë KPP, konstatohet se, operatori ekonomik “Medi - Tel” sh.p.k., ka paraqitur shkresën “Argumentim lidhur me çmimin anomalisht të ulët”, (dokument i cili nuk mban datë).

III.1.5. Gjithashtu, referuar informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, si dhe dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ky i fundit pretendon se në datë 28.07.2020 ka marrë dijeni me anë të postës elektronike, në lidhje me shkresën e autoritetit kontraktor nr.584 prot, datë 27.05.2020 me objekt “Procesverbal”, me përmbajtje: “Ankesa juaj u shqyrtua me kujdes dhe u vendos: Te merret parasysh per piken 1 te ankeses tuaj ne lidhje me ofertat anomalisht e ulta nga subjektet: Medi – Tel me oferte ekonomike 4.392.000 leke pa Tvsh; V.A.L.E Recycling me oferte ekonomike 4.680.000 pa Tvsh. Për sa më sipër ju bëjmë me dije se bazuar ne VKM nr.914, datë 29.12.2014 neni 56 te LPP kerkojme nga ana juaj argumentimin e ofertes se paraqitur pasi jeni kualifikuar si oferte e suksesshme dhe oferta juaj rezulton anomalisht e ulet pas perlllogaritjes nga komisioni”.

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, bashkëlidhur ankesës së tij, ky i fundit ka paraqitur dokumentacion ku konstatohet se, në datë 01.06.2020, operatori ekonomik “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k., i ka dorëzuar me email autoritetit kontraktor dokumentacionin në lidhje me argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

III.1.7. Në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon se “[...]”

1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

III.1.8. Në nenin 66, pika 5 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur.

- Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP-së”.

Sa më sipër referuar, nëse një apo disa oferta vlerësohen anomalisht të ulta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, ku thuhet se:

“1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:

a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;

b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;

c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;

ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertu

III.1.9. Referuar bazës ligjore të sipërcituar KPP gjykon se ligjvënësi ka përcaktuar një procedurë të caktuar për tu ndjekur në rastet kur kemi të bëjmë me oferta anomalisht të ulëta të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës. Konkretisht, parashikimi ligjor detyron autoritetin kontraktor se, kur vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementë të veçanta të ofertës.

Në rastin konkret, rezulton e provuar se, autoriteti kontraktor në datë 18.05.2020, ka kryer në sistemin e prokurimit elektronik vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Gjithashtu, nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, rezulton se ky i fundit, pasi ka kryer vlerësimin e ofertave në SPE, i ka kërkuar operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të paraqesin shpjegime për ofertat e tyre ekonomike të cilat rezultojnë anomalisht të ulëta.

KPP gjykon se, parashikimet ligjore sa më sipër, detyrojnë autoritetin kontraktor se, kur vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së.

Në rastin konkret, KPP gjykon se, autoriteti kontraktor nuk ka ndjekur procedurën e rregullt ligjore lidhur me konstatimin e ofertave anomalisht të ulëta të operatorëve ekonomikë pjesmarrës, pasi autoriteti kontraktor, ka vijuar me fazën e vlerësimit të ofertave, pa kërkuar shpjegime nga operatorët ekonomikë për ofertat e tyre të cilat rezultojnë anomalisht të ulëta, në kundërshtim me nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

III.1.10. Në nenin 64 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se *“3. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji,ka të drejtë:a) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj;c) të udhëzojë autoritetin kontraktor të korrigjojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e prokurimit të kontratës;d) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese.”*

III.1.11. Në nenin 30 *“Kufijtë e shqyrtimit të ankesës”* të Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”,* thuhet: *“[...] Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përgjashtëmsh, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre [...]”*.

III.1.12. Sipas nenit 31 pika 1 gërma “b” të Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”,* thuhet *“[...] Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës vendos me akt të motivuar: Ndalimin e autoritetit kontraktor të vazhdojë veprimet e paligjshme, duke i caktuar një afat kohor”,* ndërsa në pikën 2 , gërma “c” thuhet se: *“Nëse Komisioni vendos sipas pikës 1 shkronjës “b” të këtij neni me arsyetimin se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor është në kundërshtim me ligjin 9643/2006, dhe kontrata e prokurimit ende nuk është lidhur, atëherë Komisioni ka të drejtë: Të konstatojë shkeljen ligjore konkrete dhe të udhëzojë autoritetin kontraktor mbi korrigjimin e tyre, si dhe për vazhdimin e procedurës së prokurimit [...]”*.

Përsa më sipër , Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor që, kur vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nuk mund të shqyrtojë dhe gjykojë në themel pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Medi – Tel” sh.p.k., për sa kohë që një nga pretendimit e ngritura nga operatori ekonomik ankimues, është për parregullsi proceduriale nga ana e veprimeve të autoritetit kontraktor.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos marrë në shqyrtim themelin e ankesës së operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-56670-04-23-2020, me objekt “Sherbim Eleminim mbetjesh te rrezikshme - Marrëveshje Kuadër me nje operatorë ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)”, me fond limit 7.279.200 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 18.05.2020, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”.
  2. Autoriteti kontraktor të kryejë veprimet proceduriale sipas nenit 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe të pasqyrojë rivlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë në Sistemin e Prokurimit Elektronik.
  3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
  4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” sh.p.k.
  5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 532 Protokolli**

**Datë 08.06.2020**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

<b>Nënkryetar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Enkeleda Bega</b>	<b>Vilma Zhupaj</b>	<b>Lindita Skeja</b>	<b>Merita Zeqaj</b>

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**